

PËRFSHIRJA SOCIALE DHE SHKOLLIMI I FËMIJËVE TË KOMUNITETEVE ROM,
ASHKALI DHE EGJIPTIAN NË FUSHË KOSOVË

TEMA PËR TITULLIN
MASTER I SHKENCËS NË SOCIOLOGJI

nga

BLERINA SALIUKI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I SOCIOLOGJISË

Prishtinë

Qershor, 2026

REZYME

“PËRFSHIRJA SOCIALE DHE SHKOLLIMI I FËMIJËVE TË KOMUNITETEVE ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN NË FUSHË KOSOVË“

Mentor: Prof. Dr. Shemsi Krasniqi

Kandidatja: Blerina Saliuki

Ky punim trajton sfidat e integritit social dhe arsimor të fëmijëve që u përkasin komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në nivel lokal të Komunës së Fushë Kosovës. Arsimi përfaqëson një rol thelbësor në zhvillimin e individit dhe të shoqërisë, duke ushtruar një ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e perspektivave të punësimit, avancimin profesional dhe forcimin e përfshirjes sociale.

Pavarësisht se korniza ligjore dhe politikat arsimore në Kosovë parashohin qasje të barabartë në arsim për të gjithë qytetarët, fëmijët e këtyre komuniteteve vazhdojnë të përballen me vështirësi të shumta strukturore, ekonomike dhe sociale që kufizojnë përfshirjen e tyre të plotë dhe të qëndrueshme në sistemin arsimor.

Ky hulumtim synon të analizojë faktorët që ndikojnë në pjesëmarrjen arsimore të këtyre fëmijëve, të identifikojë sfidat kryesore me të cilat ata përballen, si dhe të vlerësojë rolin e institucioneve arsimore, familjes dhe komunitetit në promovimin e përfshirjes sociale dhe arsimore.

Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i këtij hulumtimi është të shqyrtojë, analizojë dhe vlerësojë përfshirjen sociale, si dhe sfidat arsimore që kanë nxënësit nga komuniteti Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Fushë Kosovë.

Ky studim synon të analizojë faktorët që ndikojnë në pjesëmarrjen e rregullt të këtyre nxënësve në arsim, si dhe të vlerësojë efektivitetin e politikave dhe masave të zbatuara për të siguruar mundësi të barabarta arsimore.

Objektivat specifike të hulumtimit janë:

- Analizimi i sfidave arsimore që kanë nxënësit e komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Fushë Kosovës.

- Vlerësimi i ndikimit të organizatave të shoqërisë civile dhe i masave të ndërmarra nga institucionet qeveritare në përfshirjen e tyre në arsim.
- Identifikimi i pengesave dhe mundësive që kanë fëmijët Rom, Ashkali dhe Egjiptian në përfshirjen e plotë në shkollim.
- Ofrimi i rekomandimeve për përmirësimin e mundësive dhe kushteve për një integrim të plotë të nxënësve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në sistemin arsimor.
- Analizimi i ndikimit të përfshirjes sociale në arsimimin e nxënësve Rom, Ashkali dhe Egjiptian dhe të shqyrtohet se si mundësitë për arsimim të barabartë ndikojnë në zhvillimin e përgjithshëm dhe integrimin e këtij komuniteti në shoqërinë kosovare.

Pyetjet hulumtuese

1. Në çfarë niveli të përfshirjes sociale janë të inkuadruar nxënësit e komuniteteve Rom, Ashkalinjë dhe Egjiptianë në shkollat e Fushë Kosovës?
2. Cilat janë masat dhe politikat e praktikuara në shkolla dhe institucione që ndikojnë në përmirësimin e përfshirjes sociale dhe arsimore në komunën e Fushë Kosovës?
3. Në çfarë mënyre perceptohen inkluziviteti dhe diversiteti në shkollat e Fushë Kosovës nga stafi arsimor dhe nxënësit e komuniteteve Rom, Ashkalinjë dhe Egjiptianë?

Dizajni metodologjik

Ky hulumtim është realizuar duke u mbështetur në qasjen cilësore (kualitative), e cila mundëson një analizë më të thelluar të përvojave, perceptimeve dhe qëndrimeve të individëve lidhur me përfshirjen sociale dhe arsimore të nxënësve nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Fushë Kosovë. Kjo qasje është përzgjedhur pasi ofron mundësinë për të kuptuar në mënyrë më të detajuar realitetin social dhe arsimor të këtyre komuniteteve, përmes interpretimit të përvojave dhe perspektivave të aktorëve të ndryshëm të përfshirë në këtë proces.

Të dhënat janë mbledhur përmes intervistave gjysmë të strukturuar me nxënës, prindër, mësime dhënëse, drejtore shkollash, përfaqësues institucionalë komunalë dhe përfaqësues të

organizatave joqeveritare që veprojnë në fushën e arsimit dhe të drejtave të komuniteteve. Hulumtimi është realizuar në Komunën e Fushë Kosovës, kryesisht në SHFMU “Daut Bogujevci” dhe SHFMU “Selman Riza”, përfshirë Qendrën për Punë Sociale, Drejtorinë Komunale të Arsimit dhe organizata të shoqërisë civile si dhe institucione relevante që ofrojnë mbështetje për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

Të dhënat e mbledhura janë analizuar përmes analizës tematike, duke identifikuar temat dhe kategoritë kryesore që lidhen me përvojat e pjesëmarrësve dhe sfidat e tyre në procesin e shkollimit.

Rezultatet e hulumtimit

Rezultatet e studimit tregojnë se gjatë viteve të fundit është vërejtur një rritje në regjistrimin e fëmijëve nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në sistemin arsimor. Megjithatë, përfshirja e tyre e plotë vazhdon të jetë e kushtëzuar nga një sërë faktorësh socialë dhe ekonomikë.

Gjetjet e hulumtimit tregojnë se vështirësitë socio-ekonomike, papunësia në familje, mungesa e kushteve adekuate për mësim, niveli i ulët i arsimit të prindërve si dhe përfshirja e kufizuar e tyre në procesin arsimor ndikojnë drejtpërdrejt në vijueshmërinë e rregullt të shkollimit. Po ashtu, pjesëmarrësit kanë identifikuar diskriminimin, paragjykimet shoqërore dhe stereotipet si faktorë që ndikojnë negativisht në ndjenjën e përkatësisë dhe në procesin e integritetit të fëmijëve në mjedisin shkollor.

Në këtë kontekst, shkollat, organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet komunale paraqiten si aktorë kyç në procesin e përfshirjes arsimore, duke kontribuar përmes mbështetjes edukative, mentorimit, programeve sociale dhe masave për parandalimin e braktisjes së shkollës. Në veçanti, organizatat joqeveritare si VoRAE luajnë rol të rëndësishëm në lidhjen e arsimit me mundësitë e punësimit dhe fuqizimin e komunitetit.

Megjithatë, pavarësisht këtyre përpjekjeve, mbetet e domosdoshme rritja e koordinimit ndërmjet institucioneve arsimore, autoriteteve lokale dhe organizatave të shoqërisë civile, me qëllim sigurimin e një mbështetjeje më të qëndrueshme, më efektive dhe afatgjatë për përfshirjen sociale dhe arsimore të këtyre komuniteteve.

Në bazë të rezultateve të këtij hulumtimi, evidentohet se përfshirja arsimore dhe sociale e nxënësve nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian kërkon një angazhim më të strukturuar dhe një mbështetje të qëndrueshme nga institucionet publike, organizatat e shoqërisë civile, familja dhe komuniteti.

Përfundimet

Hulumtimi evidenton se integrimi social dhe përfshirja arsimore e fëmijëve që i përkasin komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian përbën një proces të ndërlikuar dhe shumëdimensional, i cili kushtëzohet nga faktorë të ndryshëm socialë, ekonomikë dhe institucionalë. Përkundër iniciativave dhe masave të ndërmarra për zgjerimin e qasjes në sistemin arsimor, një sërë sfidash të vazhdueshme, si gjendja e rënduar socio-ekonomike, format e ndryshme të diskriminimit dhe mungesa e mekanizmave të mjaftueshëm mbështetës, vijnë të kufizojnë përfshirjen e plotë dhe të barabartë të këtyre fëmijëve në procesin arsimor.

Përmirësimi i kësaj situate kërkon intensifikimin e bashkëpunimit ndërinstitutional, fuqizimin e mbështetjes financiare për familjet në kushte të vështira, hartimin dhe zbatimin e programeve të qëndrueshme për vetëdijesimin dhe edukimin e prindërve, si dhe avancimin e praktikave gjithëpërfshirëse në arsim. Njëkohësisht, është e domosdoshme ndërtimi i një klime shkollore gjithëpërfshirëse që promovon barazinë, respektin reciprok dhe pranimin e diversitetit kulturor. Vetëm përmes një qasjeje të koordinuar, të integruar dhe afatgjatë mund të arrihet një përfshirje e qëndrueshme sociale dhe arsimore për fëmijët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Fushë Kosovës.

Fjalët kyçe

Përfshirja sociale, përfshirja arsimore, komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, Fushë Kosovë, diskriminimi, integrimi social, barazia në arsim.